

MANIFEST PËR GAZETARËT DHE NËPUNËSIT MEDIK LOKAL

PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË PUNËS

Mediat e lira lokale në të cilat punojnë gazetarë dhe nëpunës mediatik profesionist janë kyçe për zhvillimin e demokracisë dhe shoqërisë së lirë në Maqedoni. Aq kyçe sa marginalizimi ose shuarja e tyre e rrit mosdhënien e llogarisë nga autoritetet lokale, të cilët janë të prirur ta keqpërdorin pushtetin në kushte kur nuk ka media të lira lokale të cilat do të vinin re nëse respektohet interesi publik ose jo.

Por, gjatë kryerjes së punës së tyre me **interes publik**, gazetarët dhe nëpunësit mediatik të rretheve lokale (si dhe mediat) përballen me probleme ekonomike serioze, presione nga qendra të pushtetit politik dhe biznesor si dhe nga ndryshimet e shpejta në sektorin mediatik. Ata probleme sjellin rënie të cilësisë së punës së gazetarit, shtim të autocensurës dhe humbje të besimit të opinionit të mediat.

Konkretisht, problemet me të cilat përballen gazetarët dhe nëpunësit mediatik në nivel lokal janë si vijon:

Rroga të ulëta dhe marrëdhënie e parregulluar pune, gjë që sjell deri te ulja e numrit të gazetarëve dhe nëpunësve mediatik lokal dhe rreziku i shuarjes së mediave për shkak të mospasjes së kuadrit dhe kushteve të këqija të punës.

Mungesë e mjeteve për punë, hapësira dhe kushte teknike.

Mbyllje e mediave lokale për shkak të jostabilitetit financiar.

Marrja përsipër e punës së gazetarëve lokale nga shërbimet e PR-it të autoriteteve lokale dhe institucioneve shtetërore.

Konkurrencë jokorrekte nga media jo profesionale, pseudomedia dhe profile e grupe në rrjetet sociale.

Mungesë e përgjegjësisë shoqërore nga reklamuesit për rëndësinë e mediave lokale të cilat prodhojnë informacione me interes publik.

Mosrespektim i të drejtave autoriale.

Mostransparencë të autoriteteve lokale dhe mospasje të qasjes të informacionet nga njësitë rajonale për shkak të centralizimit të institucioneve shtetërore.

Reduktim të rrjetet të korrespondentëve në mediat nacionale dhe mospasje e interesimit për tema lokale nga ana e mediave nacionale.

Rrezikim i sigurisë personale dhe sigurisë së familjeve të tyre (si në jetën reale ashtu edhe në internet) dhe mostransparencë në procedura kur bëhet fjalë për rastet me gazetarë.

Gazetarët dhe nëpunësit mediatik të cilët raportojnë nga rrethe lokale janë **viktimat e parë të këtyre sfidave dhe kërcënimeve**, pas të cilëve menjëherë janë qytetarët të cilët përballen me mungesë të informacioneve të rëndësishme, profesionale dhe në kohë në hapësirat lokale.

Sindikata e pavarur e gazetarëve dhe nëpunësve të mediave, si organizatë e vetme në Maqedoni e cila i mbron të drejtat e punëtorëve dhe të drejtat profesionale të gazetarëve dhe nëpunësve të mediave në nivel nacional dhe angazhohet për lirinë e mediave, vlerëson se gazetaria në një shoqëri demokratike është **e mirë publike**.

Prandaj për ndryshim dhe tejkalim të këtyre gjendjeve alarmante dhe shqetësuese bashkë me gazetarët dhe nëpunësit mediatik nga hapësirat lokale i shpallim kërkesat si më poshtë:

1. Themelimin e **Fondit për prodhimin e përmbajtjeve mediatike** i cili para së gjithash do të jetë i orientuar nga gazetarët dhe nëpunësit mediatik lokal.
2. Ndryshim të rregullativës juridike me qëllim të detyrimit të radiodifuzerëve nacional të punësojnë **korrespondentë** nga të gjitha rajonet planore në vend.
3. **Transparencë më e madhe** e autoriteteve nacionale dhe lokale si dhe ndërprerje të praktikës së krijimit të pseudo-mediave paralele në kuadër të kabineteve.
4. **Njohja e interesit publik** nga ana e organeve gjyqësore në aspektin e të drejtës për lirinë e informimit në raste në të cilat gazetarët janë pala e paditur (padi SLAPP).
5. **Përditësim më i lartë** i policisë dhe organeve gjyqësore në rastet e sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe nëpunësve mediatik.

6. **Formimi i shërbimeve publike** / media lokale ose rajonale në rajonet planore.
7. **Mbështetje për mediat lokale** përmes subvencionimit të kontributeve për sigurim pensional dhe shëndetësor për gazetarët dhe nëpunësit e mediave.
8. **Aplikimi i masës aktive** për punësim të gazetarëve dhe nëpunësve mediatik të rinj në mediat lokale.
9. **Sigurimi i hapësirave** për qendrave të shtypit për nevojat e gazetarëve dhe korrespondentëve lokal.

Ne gazetarët dhe nëpunësit mediatik të poshtënëshkruar nga hapësirat lokale si dhe korrespondentët, me mbështetje të Sindikatës së pavarur të gazetarëve dhe nëpunësve të mediave i ftojmë të gjithë aktorët që kanë kompetenca që lidhen me mediat dhe lirinë e tyre ta pranojnë këtë **MANIFEST TË GAZETARËVE DHE NËPUNËSVE TË MEDIAVE PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË PUNËS** dhe të ndërmarrin masa për zgjidhjen e sfidave më të rëndësishme.

NËNSHKRIME